

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË “AKADEMIA PROFESIONEVE M&G” SH.P.K

Në bazë e për zbatim të Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret” si dhe legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise me vullnet te lire:

Shoqeria Momentum Group, regjistruar si person juridik prane QKB me date 02/10/2019, me NIPT L92202047J, me seli ne Tiranë, perfaqesuar nga administratori Z. Flladi Malaj, i datelindjes 16.01.1992, lindur ne Vlore e banues ne Tirane, identifikuar me leternjoftimin me nr. personal J20116084V, madhor, me zotesi të plotë juridike e për të vepruar, vendosi të themeloje e formoje si subjekt, shoqërine tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**AKADEMIA PROFESIONEVE M&G**” SH.P.K.

#### NENI 1

##### **Emri**

Emri i shoqërisë së themeluar do të jete “**AKADEMIA PROFESIONEVE M&G**” SH.P.K

#### NENI 2

##### **Humbjet**

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës se kapitalit themeltar.

#### NENI 3

##### **Selia**

Selia dhe veprimtaria e e shoqërise do të jene në adresën Rruga Zallit, Pallati anash ne hyrje te rruges, kati pare, pasuria nr. 119/9-N1, Selite, Tirane.

#### NENI 4

##### **Kohëzgjatja**

Veprimtaria e shoqërise eshte pa afat.



## NENI 5

### **Objekti**

Edukim dhe arsim profesional, trajnim per pervesimin e aftesive profesionale te fushave te ndryshme dhe ri-trajnim profesional. Edukimi, arsimi dhe ri-trajnimi do kryhet per fusha profesionale prioritare dhe qe kane potencial ne tregun e punes.

Çdo aktivitet qe perfshin kete fushe, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur. Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira, te vendos pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te realizuar qellimet e Shoqerise dhe qe lejohet nga ligji Shqiptar.

## NENI 6

### **Fillimi veprimtarisë**

Ortaku eshte dakort qe veprimtaria e dhene ne objektin e shoqerise do te filloje menjehere pas regjistrimit nga Qendra Kombetare e Biznesit.

## NENI 7

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 8000 (tetemije) euro, i cili perbehet nga kontributi i ortakut te vetem dhe ka 1 (nje) kuote.

Pjesa takuese e ortakut themelues eshte:

a) Shoqeria Momentum Group, identifikuar me NIPT L92202047J, zoteron 100 % (njqind perqind) te kuotes e te kapitalit.

## NENI 8

Kapitali themeltar mund te shtohet ose zvogelohet vetem me vendim te ortakut. Shtimi apo zvogelimi i kapitalit themeltar do te behet ne varesi te rezultateve ekonomike e ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

## NENI 9

Ndryshimet e zoterimit dhe/ose perqindjes se kuotave, qe ka ortakut themelues, behet sipas legjislacionit ne fuqi.

## NENI 10



Ortaku mund të lëne peng, si barrë siguruese apo si garanci kuotat e zotëruara në këtë shoqëri vetëm pas marrjes së një vendimi nga asambleja përgjithshme.

#### NENI 11

##### **Transferimi kuotave**

Kuotat e kapitali themeltar, që ato përfaqësojnë, mund të transferohet me anë të shitjes dhurimit apo çdo mënyre tjetër të njohur nga legjislacioni Shqiptar vetëm më vendim unanim të ortakut. Bën përjashtim nga ky rregull vetëm kalimi me trashëgimi. Transferimi tek persona të tretë, shqiptar apo të huaj, i pjesëve të kapitalit dhe kuotës që ato përfaqësojnë, bëhet me vendim unanim të ortakut.

#### NENI 12

##### **Organet e shoqërise**

Shoqëria ka si organe të saj:

- a) Asamblene e përgjithshme dhe
- b) Administratorin.

Renditja e mësipërme shpreh dhe hierarkine e organeve drejtuese të shoqërise.

#### NENI 13

Administrator i shoqërise do jetë Z. Arben Sinojmeri.

E gjithë veprimtaria e shoqërise administrohet nga administratori saj në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi.

#### NENI 14

##### **Vula**

Shoqëria ka vulen e saj ku në brëndësi të saj jepet numri tatimor i shoqërise (NUIS).

#### PËRFUNDIMI SHOQËRISE

#### NENI 15

##### **Shkrirja**



Shoqëria mbaron me të përfunduar afati i parashikuar nga ky akt ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, me anë të një vendimi të asamblese së përgjithshme dhe për shkak të falimentimi.

NENI 16

### **Likujdimi**

Në rast përfundimi, shoqëria do të nënshtrohet procedurave të likujdimit.

Për të administruar këtë procedure, asambleja e përgjithshme e ortakeve emeron një ose disa likuidatore, të cilet paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin të shoqërisë, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likujdimin.

NENI 17

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nepermjet formave të thithjes ose të bashkimit duke respektuar normat e ligjeve në fuqi.

NENI 18

Ky akt themelimi u përpilua nga ortakët themelues të shoqërisë me vullnetin e tyre të plote e të lire.

Akti u përpilua në dy kopje të njëjta, në përmbajtje të fuqi ligjore, ku një kopje do të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, ndërsa kopja tjetër mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

Tiranë më 15.06.2020

### **ORTAKU THEMELUES**

**Shoqëria Momentum Group Sh.p.k**

Perfaqësuar nga administratori i saj

**Flladi Malaj**



